

TË DREJTAT E FËMIJËS

Të drejtat e njeriut i takojnë njësoj çdo personi, për faktin se është njeri.

Por, fillimisht (dhe deri vonë), koncepti “njeri” nënkuptonte kryesisht konceptin “burrë”. Flitej e shkruhej për të drejtat e njeriut, por nënkuptoheshin kryesisht të drejtat e burrave dhe pak ose aspak të drejtat e grave, të fëmijëve, pleqve, etj. Të drejtat e njeriut, prandaj, në një mënyrë ose në një tjetër, u takonin vetëm ose kryesisht burrave.

Fëmijët janë qenie njerëzore. Të drejtat e njeriut, prandaj, u takojnë njësoj edhe fëmijëve.

Meqenëse, ndërmjet burrave, grave, pleqve, me një fjalë të të rriturve, dhe fëmijëve ka dallime të mëdha:

- fizike dhe biologjike,
- mendore (intelektuale) dhe emoconale, etj.

fëmijët kanë të drejta të veçanta dhe ato quhen Të Drejtat e Fëmijës.

Të drejtat e fëmijëve janë të artikuluar në mënyrën më të plotë dhe të përmbledhur në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, më 20 nëntor 1989, dhe të ratifikuar nga, pothuaj, të gjitha shtetet e botës.

KDF-ja, pra është shumë e vonë (1989).

Shumë jetë të fëmijëve duhet të jenë humbur ose rrezikuar nga konfliktet e armatosura, nga puna e rëndë dhe e rrezikshme për fëmijët, nga shfrytëzimi seksual i tyre, deri te zgjimi i ndërgjegjes njerëzore për shkeljen e këtyre të drejtave dhe për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me KDF-në.

Pa përmendur këtu fëmijët që jetojnë në zonat rurale, të cilët nuk kanë mundësi të shkollohen, që s’kanë qasje në shërbimin shëndetësor, që përballen me varfërinë, mungesën e strehimit, dhunën, etj.

Me ratifikimin e KDF-së, qeveritë marrin obligim që të sigurojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijës dhe, për to, mbajnë përgjegjësi edhe para bashkësisë ndërkombëtare.

Sipas KDF-së, fëmija është një qenie komplekse. Për “mirëqenien e fëmijës” duhet të plotësohen shumë kushte.

Meqenëse KDF-ja është marrëveshje e shteteve, me sisteme të ndryshme ligjore, kulturore, politike, edonomike, etj., vetëkuptohet që ajo marrëveshje është kompromis ndërkombëtar.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve është përmbledhje e të drejtave universale, standardeve dhe obligimeve të padiskutueshme të shteteve, nënshkruese të saj.

Fëmijët, kudo dhe pa dallim, kanë të drejtë:

- të **mbijetojnë**,
- të **zhvillohen plotësisht**,
- të **mbrohen nga ndikimet e dëmshme, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi**,
- të **marrin pjesë në jetën familjare, kulturore dhe shoqërore**,
- në **kujdesin shëndetësor**,
- në **shkollim dhe arsimim**,
- në **shërbimet ligjore, civile dhe shoqërore**.

Zbatimi dhe respektimi i këtyre të drejtave mundëson zhvillimin **normal, të natyrshëm dhe të plotë** të fëmijës.

Konventa u jep **rëndësi të njëjtë të gjitha të drejtave të fëmijës**. S'ka të drejta të **(pa)rëndësishme të fëmijës**. **S'ka hierarki të të drejtave** të tij. Ato janë **të pandara**.

Të drejtat e fëmijës u takojnë të **gjitha grupmoshave**.

Të drejtat e fëmijës u takojnë fëmijëve të vendeve **të pasura** dhe atyre të vendeve **të varfëra**. Nuk janë diçka që **një i pasur** ia jep **një të varfëri**, as **pronë e një grupi**, që ia jep **si dhuratë grupit tjetër**.

QËLLIMI I KDF-së

Qëllimi i KDF-së është **ndryshimi i raportit të të rriturve ndaj fëmijëve**.

Fëmijët nuk janë:

- **pronë e prindërve të tyre**,
- **objekte të papërkrahura nga bamirësia**.

Fëmijët janë:

- **subjekt i të drejtave të tyre**,
- **anëtarë të familjes dhe të komunitetit**.

Fëmijët kanë të drejta dhe përgjegjësi që i përgjigjen:

- **moshës**, dhe
- **shkallës së zhvillimit** të tyre.

KONVENTA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS AFIRMON KËTO VLERA:

E para:

- **dinjitetin njerëzor të të gjithë fëmijëve**,
- **sigurimin e mirëqenies dhe zhvillimit të tyre**.

E dyta,

- **roli i familjes në jetën e fëmijëve**,
- **për rritjen dhe mirëqenien e fëmijëve**,

- **përgjegjësia primare e prindërve për kujdesin dhe udhëzimet ndaj fëmijëve,**
- **përkrahjen materiale dhe me programe mbështetëse.**

Parandalohet **ndarja e fëmijëve nga familjet e tyre,** përveç kur gjykohet që ndarja është në të **mirë të fëmijës.**

E treta,

- respekti për fëmijët: **fëmijët kanë të drejtë të shprehin pikëpamjet e tyre** dhe ato duhet të **merren seriozisht e të peshohen drejtë,**
- fëmijët kanë **përgjigjësi t'i respektojnë të drejtat e të tjerëve, veçanërisht të drejtat e prindërve,**
- respektimi i "**kapaciteteve zhvillimore**" të fëmijës: **fëmijët nuk kanë të drejtë të marrin vendime për veten e tyre në moshë shumë të re,**
- rruga e fëmijës nga **varësia e plotë deri te pjekuria e tij është graduale.**

E katërta,

- mosdiskriminimi: **shteti duhet t'i identifikojë fëmijët që janë më të rrezikuar dhe të sigurojë të drejtat e atyre fëmijëve.**

E pesta,

- Obligimi i shteteve për nxjerrjen e **legjislacionit kombëtar, në harmoni me kërkesat e KDF-së,**
- Kështu, standardet për të drejtat e fëmijës **nuk janë më aspiratë, por detyrime për shtetet.**
- Shtetet japin **llogari publike dhe ndërkombëtare** për veprimet që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës.
- **Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, organ i pavarur monitorues i të drejtave të fëmijës.**

DEFINIMI I MOSHËS SË FËMIJËS

Qenie njerëzore **deri në moshën 18-vjeçare,** me **përjashtim kur ligjet kombëtare njohin moshën madhore më të hershme.** Në këtë rast shtetet duhet **të veprojnë në përputhje me parimet e KDF-së: mosdiskriminimi, interesat e fëmijës, zhvillimi maksimal.**

Shteti obligohet të tregojë **nëse legjislacioni kombëtar ndryshon nga Konventa** sa i përket definimit të mashës së fëmijës.

Shtetet janë të obligura të definojnë moshën, p. sh.

- për **pranim në punë** ose
- për **përfundimin e arsimit të detyruar.**

Konventa shprehet qart:

- **dënimi kapital (me vdekje ose burgim të përjeshëm) ndalohet për moshën deri në 18 vjeç,**
- **ndalohet përfshirja e personave deri në 18 vjeç, në konflikte të armatosura,**

- **ndalohet rekrutimi i personave deri në moshën 18 vjeç në forcat e armatosura dhe pjesëmarrja direkte e tyre në armiqësi.**

Shtetet **janë të lira** që në legjislacionin e tyre kombëtar të përcaktojnë **moshën më të madhe se 18 vjeç, për definimin e fëmijës.**

PYETJET:

1. Ku mbështeten dallimet ndërmjet “të drejtave të njeriut” dhe “të drejtave të fëmijës”?

.....
.....

2. Në cilin akt ndërkombëtar janë artikuluar të drejtat e fëmijës?

.....

3. Të drejtat universale të fëmijës, të përmbledhura në KDF,
 - a) Mund të kontestohen nga shtetet-nënshkruese të saj,
 - b) Janë të padiskutueshme.

4. Cilat janë të drejtat e fëmijëve?

.....
.....
.....

5. A ka hierarki të të drejtave të fëmijëve?

- a) Po,
- b) Jo.

6. Fëmijët e moshës 14-18 vjeçare kanë më shumë të drejta se fëmijët e moshës 10-14 vjeçare:

- a) Po,
- b) Jo.

7. Fëmijët e vendeve të pasura dhe ata të vendeve të varfëra:

- a) kanë të drejta të barabarta,
- b) nuk kanë të drejta të barabarta.

8. Cili është qëllimi i KDF-së, në raportet ndërmjet të të rriturve dhe fëmijëve?

- a) Ndryshimi i raporteve të të rriturve ndaj fëmijëve,

b) Ruajtja e raportve tradicionale ndërmjet të të rriturve dhe fëmijëve.

9. Cilat vlera i afirmon KDF-ja:

.....
.....

10. Kur, sipas, KDF-s, lejohet ndarja e fëmijës nga familjet e tij?

.....
.....

11. Fëmijët kanë përgjegjësi për respektimin e të drejtave të të tjerëve.

- a) Po,
- b) Jo.

12. Fëmijët nuk kanë të drejtë të marrin vendime për vetveten.

- a) Po,
- b) Jo.

13. Periudha e fëmijërisë, sipas KDF-së, përfundon në moshën:

- a) 14 vjeçare,
- b) 16 vjeçare,
- c) 18 vjeçare.

14. KDF-ja ndalon dënimin kapital për personat

- a) deri në moshën 18 vjeçare,
- b) deri në moshën 16 vjeçare.